ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **K.R.U RADONIQI**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KRU-26-5880-2-1-3**

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i projketit dhe Dizajnin Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini per zonen e Rahovecit,Suharekes,Mamushë dhe Prizren.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

TAULANT SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Mat - Prishtinë
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

045-150-123
Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Ditika Qatipi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpk.taulant2@gmail.com
(Adresa elektronike)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË "TAULANT" Shpk TIRANË ALBANIA

23.11.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)
(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Më datën 29.09.2026 është publikuar njoftimi për kontratë. *• Afati i dorëzimit ofertave , data 12.10.2026 koha 13:00 E-PROKURIM* *• Hapja e ofertave po të njëjtën datë : 12.10.2026 koha 13:00 E-PROKURIM*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Edhe pse në e-prokurim figuron tenderi jonë i paraqitur , nuk figuron i përfshirë në procesverbalin e Hapjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 38 LPP-së
Neni 55 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së paragraf
Neni 69 i LPP-së paragrafi 1
Neni 35 i RrPP-së paragrafi 4 ,5,6,7,8,9,10

Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Më datën 12.10.2026 para orës 13.00 e kemi ngarkuar dosjen , mipo nuk kemi marrë procesverbalin , KRU nuk e ka publik në platformë procesverbalin e hapjes , ndërsa më datën 06.11.2026 e ngarkon në plaform e-prokurimi Vendimin e AK , dhe kuptojmë që oferta jonë nuk është përfshirë as në procesverbal hapjes po ashtu nuk është përfshirë në Vlerësimin e AK.

Më datën 12.11.2026 na është refuzuar kërkesa për rishqyrtim e datës 11.11.2026 me arsyetim është e pa lejuar

KOMPANIA REGJIONALE E UJITJES
REGIONAL IRRIGATION COMPANY, J.S.C
REGIONALNA KOMPANIJA ZA NAVODNJAVANJE D.D
"Radoniqi-Dukagjini" Sh.A.
Rr. UÇK-së p.n Gjakovë, Kosovë
Tel. 0390/320-054, Tel. Fax 0390/320-536

Kompania Regionale e Ujitjes-SH.A.
Regional Irrigator Company J.S.C.
Regionalna Kompanija za Navodnjavanje-D.D.
"Radoniqi-Dukagjini"
DALJE
Nr.Prot. 775 Data 12.11.2026

DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Gjakovë: 12.11.2026

Zyrtari Prgjegjs i Prokurimit, n mbshtetje t nenit 108/A (paragrafi 2) t Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotsuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar n nenin 6 (paragrafi 6.1) t Rregulls pr Parashtrimin e Ankesave t publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkess pr ri-shqyrtim, t parashtruar nga Operatori Ekonomik lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Hartimi i projketit dhe Dizajnin Teknik për rehabilitimin e kanalit të ujitjes dhe zgjerimin e sistemit të ujitjes së Radoniqit-Dukagjini per zonen e Rahovecit,Suharekes,Mamushë dhe Prizren.
me Nr. të Prok **KRU-26-5880-2-1-3** nxjerr:

AKT-VENDIM
MBI KERKESEN PER RISHQYRTIM

I. **Refuzohet si pa lejuar**, kerkesa per ri-shqyrtim e dorezuar nga TAULANT SH.P.K. dorezuar permes plateformes elektronike me dt 11.11.2026

II. **Mbetet ne fuqi NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK i publikuar me dt.06.11.2026**

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues (AK) ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim nga TAULANT SH.P.K më dt. 11.11.2026. Pas shqyrtimit të plotë të dokumentacionit që AK ka në dispozicion përmes formës së rregullt të procedurës, kemi vërtetuar se OE TAULANT SH.P.K nuk ka dorëzuar ofertë të rregullt në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dispozitat ligjore në fuqi. Konkretisht, në kundërshtim me nenin **55, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (LPP) (i ndryshuar dhe plotësuar) dhe nenin 55 të Rregullores për Prokurim Publik Nr. 002/2024 (për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022), OE nuk i ka dorëzuar dokumentet/ofertën përmes follderave (skedar) të mbyllura (me fjalëkalim) në formë elektronike (share drive – linkun) duke e ndarë qasjen me personin kontaktues (emailin)** të AK. Me këtë rast, AK nuk ka pasur dhe nuk ka qasje në këtë fazë të ofertës nga TAULANT SH.P.K, rrjedhimisht AK e ka të pamundur ta dijë se një ofertë e tillë ekziston fare.

Njëkohësisht, duke qenë se OE nuk ka dorëzuar ofertë në përputhje me kërkesat ligjore të lartcekura, në kuptim të nenit 4 të LPP-së (përkufizimi i "Palës së interesuar"), i njëjti është palë pa interes në këtë fazë të aktivitet të prokurimit. Rrjedhimisht, në mungesë të legjitimitetit aktiv si palë e interesuar, kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga OE TAULANT SH.P.K. refuzohet si e palejuar.

Keshille juridike:
Kunder ketij vendimi palet e pakenaqura mund te parashtrojne ankese ne përputhje me rrethanat e Nenit 108/A i cila duhet te dorzohet pranë OSHP-s.

Menaxher i Prokurimit
Fatmir Mehmetaj

Ne kemi dorëzuar Dosjen e tenderit konform Skedareve të pregdituar në Formën e-prokurimit ku është plotësuar Në Dy pjesë Metologjia dhe Stafi në një Folder si dhe Oferta financiare në Folder dytë , për secilin Folder kemi dhënë edhe Kodin e Identifikimi

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në Kundershtim me NENI 35 RRUOP
Neni 35 – Hapja e tenderëve (Paragrafët 35.11 dhe 35.12)

35.11. Pas përfundimit me sukses të hapjes publike, çelësat publikë të nevojshëm për dekriptimin e tenderëve ruhen në bazën e të dhënave të sistemit. Kjo mundëson që tenderët të analizohen dhe vlerësohen në vijim pa pasur nevojë për futjen e sërishme të çelësave, duke qenë se të dhënat e tenderëve tashmë janë bërë publike gjatë procedurës së hapjes dhe nuk kërkohet më mbajtja e tyre në formë të enkriptuar.
35.12. Në rast të paraqitjes së problemeve teknike në sistemin e prokurimit elektronik gjatë procedurës së hapjes publike të ofertave elektronike — konkretisht kur shfaqen pengesa në:

- **i)** paraqitjen e çelësave privatë;
- **ii)** inspektimin e regjistrit të ofertave të dorëzuara në mënyrë elektronike; ose
- **iii)** inspektimin e vetë ofertave të dorëzuara;

Autoritetet Kontraktuese (AK), Operatorët Ekonomikë (OE) dhe Tavolina Ndihmëse e Teknologjisë së Informacionit (TI) në KRPP veprojnë sipas procedurës së përcaktuar si në vijim:

- **a) Raportimi i menjëhershëm:** Autoriteti Kontraktues ose Operatori Ekonomik obligohet që menjëherë të njoftojë dhe të raportojë me shkrim pranë Tavolinës Ndihmëse të TI-së në KRPP, përmes mjeteve më të shpejta të komunikimit (linjës telefonike dhe postës elektronike), brenda orarit zyrtar të punës (nga e hëna deri të premten, prej orës 08:00 deri në 16:00).
- **b) Verifikimi dhe ndërhyrja teknike:** Pas pranimit të raportimit, Tavolina Ndihmëse e TI-së dhe administrimi i sistemit të e-Prokurimit në KRPP kryen verifikimin teknik të sistemit. Nëse konfirmohet ekzistenca e pengesave teknike, KRPP-ja ndërmerr veprimet e nevojshme teknike në platformë, në pajtim me procedurat e saj të brendshme, për të garantuar trajtimin e drejtë të aktivitetit të prokurimit dhe të ofertave të dorëzuara.

AK i ka ikur një Veprimi të tillë

Kërkojmë nga OSHP ta anuloj Vendimi e AK të datë 06.11.2026 dhe ta anuloj tenderin , pasi Oferta jonë edhe pse figuron e dorëzuar nuk është regjistrua në procesverbal hapjes apo ashtu nuk është bërë as vlerësimi i saj.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne si OE kemi pësuar dëme të konsiderueshme. Dëmet e pësuara (materiale dhe jo materiale) deri në këtë fazë të procedurës janë në vlerë 350,000 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*